



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE

K.DH.SH.II.nr. 681/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Vahide Krasniqi kundër të paditurës I.... shpk nga Prishtina, me administrator Q.S., të cilin e përfaqëson Milot Spahiu avokat në Gjilan, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, C.nr.373/20 i datës 21.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 24.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e paditëses Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, C.nr.373/20 datës 21.04.2021, dhe Lënda i kthehet Dhomës së Shkallës së parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, me Aktgjykimin e atakuar C.nr.373/20 i datës 21.04.2021 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka Refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura I.... shpk nga Prishtina, që paditëses në emër të pagesës që qirasë për periudhën nga data 05.10.2010 e deri me 05.08.2012 për lokalitë në Prishtinë lagja ... nr.19/3.,ia paguaj shumën prej 14,259.10€ me kamatë në lartësinë të cilën e paguan bankat vendore si për mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar prej datës 08.06.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nën kanosjen e përmbartimit ligjor. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka detyruar paditësen që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj të paditurës shumën në lartësi prej 540.80€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësja Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, për shkak të vërtetimit të shkeljes së dispozitave të procedurës

kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa e paditëses të aprovohet si e bazuar, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe çështja i kthehet për rishqyrtim gjykatës së shkallës së parë, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të miratohet në tërësi si e bazuar.

Në përgjigje në ankesë përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, e kundërshton në tërësi ankesën e paditëses, duke propozuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi C.nr.373/2020 i dt.21.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, të vërtetohet në tërësi dhe tani paditurit ti njohën shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë në vlerë prej 312.00€.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Vahide Krasniqi, me datën 17.09.2012 ka paraqitur padi kundër të paditurës I..... shpk nga Prishtina, me administrator Q.S., të cilin e përfaqëson Milot Spahiu avokat në Gjilan, për shkak të lirimit të lokalit afarist dhe pagimin e borxhit.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim, me Aktgjykimin e ankimuar C.nr.373/20 datës 21.04.2021 e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura I..... shpk nga Prishtina, që paditëses në emër të pagesës që qirasë për periudhën nga data 05.10.2010 e deri me 05.08.2012 për lokalin i cili gjendet në Prishtinë lagja ... nr..... T'ia paguaj shumën prej 14,259.10€ me kamatë në lartësinë të cilën e paguan bankat vendore si për mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar prej datës 08.06.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes se aktgjykimin nën kanosjen e përmbarimit ligjor. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimin ka detyruar paditësen që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj të paditurës shumën në lartësi prej 540.80€. Gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, sipas detyrës zyrtare ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1, pika (f) e LPK-së, që përbejnë arsye për prishjen e këtij aktgjykimi. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, sipas detyrës zyrtare dhe duke i'u referuar nenit 19 të LPK-së gjeti se secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdesët për kompetencën e vet lëndore, ndërsa në rastin konkret gjeti se gjykata e shkallës së

parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 17.1 të LPK-së ku thuhet se “ Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur” dhe nenit 29 të LPK-së ku thuhet se “në procedurë kontestimore gjykatat gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vet lëndore të caktuar me ligj”.

Madje edhe duke u bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054, *ka rezultuar* se palët ndërgjyqëse nuk ka mundur të jenë palë në procedurë për këtë rast në këtë Departament të kësaj Gjykate, sepse palët e kanë statusin e shoqërive tregtare të regjistruar si: Aksionar publik dhe SHPK-së.

Me aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur sipas kërkesëpadisë së paditëses duke mos pasur kompetencë lëndore për zgjedhjen e kësaj çështje juridike dhe në këtë rast ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1 pika (f) e LPK-së, që parasheh se shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston “në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër”. Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore qëndrojnë në atë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë ose gjykata e llojit tjetër.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, si fakt vendimtar në vendosjen e kësaj çështje juridike si në dispozitiv të aktgjykimit, ka marrë për bazë ndryshimet ligjore që kanë rezultuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, e shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës datë 10 shkurt 2022, i cili Ligj në dispozitën e nenit 13 paragrafi 2, ka përcaktuar çështjet që trajtohen në kompetencë të Departamentit për çështje ekonomike. Andaj duke marrë parasysh edhe objektin e kontestit në këtë çështje juridike, Kolegji erdhi në përfundim se Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetent të trajtojë këtë çështje juridike kontestimore.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, është kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se palët ndërgjyqëse kanë statusin e aksionarit publik dhe SHPK-së, si shoqëri tregtare, dhe me padi paditësja pretendon se me palën e paditur janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, dhe nenit 12,13 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.681/22 data 24.10.2022

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Krenar Berisha